REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-2045
Dt.08.02.2018

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport e Komunës së Gjakovës,** për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë me destinim - Ndërtimi i Fushës së Futbollit me bari Sintetik, hapësirës për parkingje, rendeve për ulëse dhe, objektit përcjellës të zhveshëtores dhe nyjeve sanitare, konform Vendimit me Nr. 01-Nr. 011/01-2010/2018, të datës 07.02.2018, nga K.K.Gjakovë, në kompleksin Zona Peizazh i Mbrojtur "Shkugëza", me etazhitet të objektit etazhitet **P+0,** në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

A K T V E N D I M

I. I LEJOHET: aplikuesit: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport e Komunës së Gjakovës, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë me destinim – Ndërtimi i Fushës së Futbollit me bari Sintetik, hapësirës për parkingje, rendeve për ulëse dhe, objektit përcjellës të zhveshëtores dhe nyjeve sanitare, konform Vendimit me Nr. 01-Nr. 011/01-2010/2018, të datës 07.02.2018, nga K.K.Gjakovë, në kuadër të Planit Rregullues Urban Zona Peizazh i Mbrojtur "Shkugëza", në ngastrën kadastrale me numër 107/0, ZK: Firzë, në pronësi të Republikës së Kosovës, në rrugën "Nikollë Kaçorri" e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objekit është **P+0,** në sipërfaqe të përgjithshme (bruto) e objektit përcjellës: **S=823.00 m²**

Përdhesa e objektit përcjellës: (Sip,Bruto): ..... S=823.00 m²

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Vendimi nga K.K.Gjakovë, me nr. 01.nr.011/01-2010/2018, dt.07.02.2018.

III. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë për Punë Inspektuese, për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit të lokacionit të piketuar.
- Për Objektet e kategorisë së dytë, Investitori duhet që për secilën fazë të ndërtimit, të parashtrojë kërkesë, pranë Drejtorisë për Punë Ispektuese, me qëllim të Inspektimit dhe përcjelljes së realizimit të punimeve nga secila fazë, si dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për lëshimin e Certifikatës - Lejes së Përdorimit të objektit.

IV. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport e Komunës së Gjakovës, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM-së, me nr. 07/351/01-19787, të datës 11.09.2017 për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë me destinim – Ndërtimi i Fushës së Futbollit me bari Sintetik, hapësirës për parkingje, rendeve për ulëse dhe, objektit përcjellës të zhveshëtores dhe nyjeve sanitare, konform Vendimit me Nr. 01-Nr. 011/01-2010/2018, të datës 07.02.2018, nga K.K.Gjakovë, në kompleksin Zona Peizazh i Mbrojtur "Shkugëza", me të objektit etazhitet P+0, në ngastrën kadastrale me numër 107/0, ZK: Firzë, në rrugën "Nikollë Kaçorri" siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Kopjen e planit të datës 08.02.2018, në pronësi të në pronësi të Republikës së Kosovës, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.

2. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndësve 1197/18 dt.08.02.2018, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.

3. Lejen Mjedisore Komunale, me nr. 07-351/01-2061, dt.08.02.2018, të lëshuar nga DUMM.

4. Njoftimin nga Sekretari Gjeneral, Federata e Futbollit e Kosovës, e datës 24.01.2018.

5. Vendimi për ndarjen e parcelës për ndërtimin e fushës Sintetike, me nr. 01.Nr.011/01-2010/2018, dt.07.02.2018, nga K.K.Gjakovë.

I liruar nga taksa administrative, në bazë Nenit 5, parafgrafi 5.15. nënparagrafi b), të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, me nr. 01 Nr.011-43964/2015, dt.30.06.2015.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:
- **Investitorit,**
- **Drejtorisë së Inspekcionit ,**
- **Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,**
- **Arkivit.**

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani, jur.dipl.

D r e j t o r i

Arben Bakalli, jur. i dipl.